

Maj 2023



Student

**CAMBRIDGE NË
TES?**

**Aromë
manxurane**

*Mos
kini frikë të
ëndërroni...*

**Aktorja Anisa
Markarian në një
rrëfim të çiltër**

**Teatër
"Karnavalet e Korçës"**

*Gjuha shqipe është
gjuha e shpirtit, e
rrënjëve tona...*

*Intervistë me përkthyesen
Anxhela Çikopano*

**Konferenca e
filozofisë, traditë e
edukimit**

**Erlisa Demneri, nga
shkolla "TES" drejt e në
"Harvard"**

**E para në Shqipëri
në *Public speaking***

PASQYRA E LËNDËS

CAMBRIDGE NË "TES"?	03
CAMBRIDGE DAY	04
INTERVISTË ME DREJTORESHËN E SHKOLLËS.....	05
INTERVISTË ME AKTIVISTIN A. LAPAJ.....	07
RRËFIMI I ÇILTËR I AKTORES A. MARKARIAN	09
QEVERIA E NXËNËSVË.....	11
MUJTI I LETËRSISË	13
NË EKSPOZITËN E PIKTORIT R. SHABANI.....	15
PROJEKTI "VENDIËNDJA, ÇAMËRIA".....	17
FESTA E MËSUESIT	19
NË TEATRIN "ZONJA E BUJTINËS".....	21
INTERVISTË ME PËRKTHYESIN A. ÇIKOPANO	23
A. KËRÇISHTA NË KONKURSION "SHQIPËRIA IME"	25
EKSPOZITA E PIKTURËS	26

E. DEMNERI NGA "TES" DREJT E NË "HARVARD".....	27
KOSOVA JONË 15 VJET E PAVARUR.....	29
E PARA NË SHQIPËRI NË PUBLIC SPEAKING	30
KONFERENCA E FILOZOFISË	31
SHFAQJA TEATRALE "KARNAVALET E KORÇËS".....	33
KOMPANIA E NXËNËSVE "KACAMISTRI".....	35
EKSPOZITA "TË JETOSH NË KOMUNIZËM".....	37
DITA E TOKËS	38
DITA EVROPIANE E GJUHËVE TË HUAJA.....	39
JAVA E GJUHËVE TË HUAJA.....	40
JAVA E SHKENCËS	42
KLUBET.....	43

TOMORROW'S EDUCATION SYSTEM CAMBRIDGE NË TES?

PO!

Këtë vit shkollor, shkolla jonë nisi për herë të parë implementimin e kurrikulës angleze, paralelisht me kurrikulën shqiptare, për ciklin fillor, ndërkohë që në datën 3 prill 2023 u licensuam si një shkollë ndërkombëtare e Cambridge.

Krahas gjuhës angleze, në të gjitha klasat e arsimit fillor, nxënësit janë duke zhvilluar lëndën e Matematikës dhe të Shkencës në anglisht me tekstet e *Cambridge University Press*.

Duke qënë se këto mësuese zhvillojnë lëndën gjuhë angleze me nxënësit, është më e thjeshtë për to të përshtasin mësimet duke u bazuar në nivelin e nxënësve dhe klasave.

Fokusi 2 vitet e para do të jetë tek Soft CLIL (Content and Language Integrated Learning).

Në vitet në vijim, kur nxënësit të kenë arritur të kuptuarit e plotë të koncepteve shkencore në gjuhën angleze dhe ta kenë fituar lirshmërinë e të shprehurit me terminologjinë e duhur në anglisht, do të merret në konsideratë mundësia e Hard CLIL ku nxënësi fokusohet te koncepti matematikor/shkencor dhe si rrjedhojë perfeksionon edhe të shprehurit duke përdorur terminologjinë e duhur në anglisht.



Nëpërmjet kurrikulës së Cambridge ne synojmë të arrijmë disa objektiva :

- Të njohim nxënësit dhe mësuesit me kurrikulat dhe qasjen ndërkombëtare ndaj arsimit
- Të nxisim kuriozitetin, kreativitetin dhe mendimin kritik tek nxënësit
- Të orientojmë nxënësit drejt komunikimit dhe bashkëpunimit si rruga e duhur drejt suksesit
- Të edukojmë nxënës të përgjegjshëm, me vetëbesim, të hapur ndaj risive dhe të gatshëm për të bërë diferencën
- Të pajisim nxënësit me një fjalor të pasur me terminologji matematikore dhe shkencore në gjuhën angleze
- Të pregatisim nxënësit për të ardhmen.

Avantazhet e të qenit një shkollë e licensuar nga Cambridge:

- Ø Kurrikul ndërkombëtare
- Ø Testime të njohura ndërkombëtarisht
- Ø Siguri për të ardhmen (universitet/punë)
- Ø Trajnime të vazhdueshme për stafin

Në shtator 2023 do të shtrijmë kurrikulën e Cambridge edhe në Arsimin e Mesëm të Ulët (klasa VI-IX) ku në mësimdhënie do të përfshihen mësuesit e shkencave natyrore të cilët janë duke u trajnuar nga Cambridge Assessment International Education.

NXISIM KURIOZITETIN DHE DËSHIRËN E PËRJETSHME PËR DIJE !



CAMBRIDGE DAY



Për të parin vit, shkolla "TES" organizoi Cambridge Day për ciklin fillor.

Në këtë ditë nxënësit festuan për arritjet e tyre në lëndët Cambridge Primary Mathematics dhe Cambridge Primary Science nëpërmjet një panairi punimesh nga më të larmishmet dhe më kreativitet.

Plot me lojëra, eksperimente dhe punime 3D, ky panair solli shumë gëzim te të gjithë nxënësit dhe të ftuarit. Cambridge Day, duke filluar nga viti i ardhshëm, do të organizohet edhe për arsimin e mesëm të ulët duke qenë se kurrikula e Cambridge-it, pas licensimit si një shkollë ndërkombëtare e Cambridge-it, do të shtrihet edhe në këtë cikël mësimor.

INTERVISTË ME DREJTORESHËN E SHKOLLËS, LULJETA BASHA

“MATEMATIKA ËSHTË FIZKULTURA E TRURIT, MUZIKA ËSHTË FIZKULTURA E SHPIRTIT DHE SPORTI ËSHTË FIZKULTURA E TRUPIT”

(Me të hyrë në zyrë një përshëndetje e ngrohtë e veshi ajrin dhe biseda rrodhi lirshëm e shtruar. Edhe pse mes shumë punësh, zhytur mes shkresash, drejtoresha la gjithçka dhe u përgjigj çiltërsisht për ne.)

Ju keni shumë vite në arsim dhe së fundmi keni vendosur të drejtoni shkollën tonë, e cila i përfshin të trija ciklet e arsimit. A paraqiti ky vendim një sfidë të re për ju dhe si po e përjetoni këtë përvojë?

Unë kam 20 vite që drejtoj shkolla të mesme, kam qenë edhe mësuese përpara se të bëhesha drejtoreshë, por natyrisht që ky vendim përbën një sfidë për mua, pasi është hera e parë që punoj në një shkollë private dhe madje me tre cikle. Por, njeriu nuk është keq që t'i provojë të gjitha gjërat. Nxitja kryesore ishte të provoja një shkollë private dhe shtyrsa tjetër ishte ambienti dhe kolegët e dashur.

Cilat janë objektivat që synoni të realizoni në shkollën tonë?

Objektivi kryesor ishte të integroja njohuritë e mia nga eksperiencat në shkollat publike me shkollën tuaj private. Kam shumë dëshirë që të renditemi ndër të parët midis shkollave publike dhe private, të rrisim numrin e pjesëmarrësve në konkurset kombëtare dhe ndërkombëtare. Kemi mjaft pjesëmarrës dhe fitues, por synojmë të arrijmë më shumë.



JETA ËSHTË E BUKUR, E MREKULLUESHME, POR NUK REALIZOHET ASGJË PA PUNË E PA MUND



LULJETA BASHA

Si një grua me karrierë të gjatë e plot arritje, a mund të ndani me ne çelësin e suksesit tuaj?

Unë mendoj se është përkushtimi. Unë jam shumë e përkushtuar në punën që bëj dhe nuk neglizhoj asnjë nga detyrat e mia.

Çfarë mesazhi do të donit të përcillnit te lexuesit e kësaj reviste?

Motoja ime është që ne mësuesit fillimisht duhet të punojmë që të edukojmë mendjen dhe pasi të kemi edukuar mendjen, kemi edukuar edhe shumë gjëra të tjera.

Matematika është fizikultura e trurit, muzika është fizikultura e shpirtit dhe sporti është fizikultura e trupit. Po qe se ne edukojmë mendjen dhe punojmë fort, a ka gjë që na ndalon të ecim përpara?

Mesazhi im është: Punoni, punoni, punoni! Ju e keni jetën përpara dhe do të shikoni se ajo është një luftë e pandërprerë. Jeta është e bukur, e mrekullueshme, por nuk realizohet asgjë pa punë e pa mund.

“SHQIPËRIA KA
RININË DHE
MIRËQENIA DO TË
NDRYSHOJË !”

ADRIATIK LAPAJ

Njeriu dhe roli e tij në shoqëri, tema e diskutuar nga aktivisti dhe juristi Adriatik Lapaj, i cili i bëri të gjithë gjimnazistët të jenë pjesë e bisedës.



ADRIATIK LAPAJ

Mbresat e kësaj bisede i frymëzuan gjimnazistët për t'u bërë aktiv në shoqëri dhe për të dhënë kontributin e tyre në të ardhmen.



“JETA ËSHTË NJË TËRËSI
FREKUENCASH DHE
AUREOLASH QË
KRIJOJNË ENERGJINË E
DUHUR PËR T’I ARRITUR
ATO QË DUAM NË JETË !”




Z.Lapaj solli shembuj të ndryshëm se si secili prej nesh mund të kontribuojë në të mirën e përbashkët duke u angazhuar në iniciativa për pastrimin e habitateve ujore në gjelbërimin e zonave urbane e në çdo akt vullnetarizmi që siguron përmirësimin e jetës sonë në këtë shtëpi të madhe që quhet NATYRË .

Motoja e aktivistit në këtë thirrje qe:
"Çdokush nga ne duhet ta shohë Shqipërinë si një mundësi për ta ndryshuar e jo për t'u dorëzuar dhe për t'u larguar nga ajo!"

Mjaftoi kjo dhe salla u pushtua nga bisedat dhe nga një valë entuziazmi mes gjimnazitëve.

Shqipëria ka rininë, mjafton dëshira e të rinjve dhe ky ndryshim do të vijë!



ANISA MARKARIAN
" SHTËPIA TE SELVIA "



“MOS
KINI FRIKË TË
ËNDËRRONI, SEPSE EDHE
ËNDRRAT MË TË
GUXIMSHME
BËHEN REALITET !”

ANISA MARKARIAN

Aktorja e njohur shqiptare, mjekja e shkrimtarja, Anisa Markarian zhvilloi një bisedë me nxënësit e shkollës sonë, rreth romanit të saj më të ri me titull *Shtëpia te Selvia*.

Në drejtimin e mësueses Orilda Kalami, shkrimtarja rrëfeu copëza nga jeta e saj, marrëdhënia me prindërit, arti në Shqipëri, emigracioni dhe e vuri theksin te forca që njeriu ka brenda vetes për të arritur gjithçka.



TAKIMI NË SALLËN E KINEMATOGRAFISË

Të mos kini pishmallëqe në jetë, kapeni jetën nga brirët dhe drejtojeni ju!

E pyetur mbi frymëzimin për shkrimin e romanit, aktorja u përgjigj se respektimi i rrënjëve, i identitetit, përcimi i vlerave dhe dashuria për prindërit, e nxitën të rrëfente për lexuesit jetën e familjes së saj.

E thjeshtë, madhështore në përrulësinë e saj, pasionante dhe frymëzuese, Anisa Markarian përcolli emocione dhe mesazhe plot vlerë për nxënësit.





QEVERIA E NXËNËSVE



Qeveria e nxënësve është ndër organet më të rëndësishme të shkollës. Që nga krijimi i saj aktivitetet e qeverisë kanë arritur të zhvillojnë frymën e komunitetit mes nxënësve dhe kanë ndihmuar në eksplorimin e mundësive dhe të nismave të ndryshme. Qeveria është e përbërë nga senatorët e klasave të ciklit AML dhe AMU, dhe udhëhiqet nga mësuesja koordinatore Irida Xhura. Çdo vit, të shoqëruara me fushatën e kandidatëve, zhvillohen zgjedhjet për presidenten dhe këshillin e qeverisë.

Kështu, qeveria e nxënësve është e ndryshme nga një klub ose organizatë jashtëshkollore, së cilës studentët zgjedhin t'i bashkohen, por është më tepër një institucion politik i pashmangshëm që formëson përvojën shkollore falë veprimit të saj, përmes përfaqësimit të përbashkët në vendimmarrjen arsimore, përkrahjes së nxënësve dhe aktivizimit të tyre. Qeveria ofron shërbime për të zbatuar idetë e nxënësve, dhe për të menazhuar, rregulluar dhe nxitur aktivitetet jashtëshkollore. Ajo është e rëndësishme, sepse është mënyra më efektive dhe e barabartë që nxënësit të kenë një zë në edukimin e tyre dhe të përmirësojnë eksperiencën shkollore.

Qeveria e nxënësve ka ndihmuar gjithashtu në nxitjen e ndjenjës së komunitetit dhe të përkatësisë brenda shkollës. Nxënësit kanë marrë pjesë në procesin e vendimmarrjes dhe janë ndjerë të vlerësuar, gjë që nxitur një kulturë pozitive. Qeveria ka realizuar aktivitete të ndryshme ndër vite, si fushatat e bamirësisë, panairët e ushqimeve dhe ekskursionet.

Si përfundim, duke marrë pjesë në këtë organ, nxënësit kanë fituar aftësi dhe përvoja që do t'i shërbejnë në eksperiencat e ardhshme personale dhe profesionale.



QEVERIA E NXËNËSVE DHE MËSUESJA KOORDINATORE



Shpërndarja e 112 pakove me ushqime për familjet në nevojë në zonën Zallbstar.




Qeveria e nxënësve, nën koordinimin e mësueses Irida Xhura, organizoi Panairin e ushqimeve, me qëllim mbledhjen e të ardhurave për një kauzë të rëndësishme. Gatime tradicionale, receta moderne, ëmbëlsira e të kripura u shijuan prej të gjithëve. Tryezat e panairit u boshatisën sa hap e mbyll sytë.




Bashkëpunimi dhe disiplina në realizimin e detyrave të ngarkuara, siguroi mbarëvajtjen e panairit dhe dëshmoi se nxënësit tanë janë kreativë, të përgjegjshëm dhe empatikë.

Panairi i ushqimeve nuk ishte vetëm një mundësi për t'u argëtuar e për të gjallëruar jetën shkollore, por edhe për të nxitur vullnetarizmin, altruzimin e për të ndarë me njëri-tjetrin kultura e tradita përmes gatimeve.

Paratë e mbledhura u shfrytëzuan për blerjen e një pajisjeje elektroshtëpiake, e cila iu dhurua një familjeje në nevojë.





REJSI AHMETAJ
PREZANTUESE



XHEMILA HUSHA
NË ROLIN E SOKRATIT



ART, LETËRSI,
POEZI, KËNGË,
DIJE, ARGËTIM !



Mine Mena
Interpretimi i poezisë "Ti do t'më dashurosh patjetër",
shoqëruar në kitarë nga Adrian Plakalli

Letërsia është vlerë estetike dhe edukuese, ajo lëmon shpirtin dhe ofron njohjen e botës. Përmes interpretimeve në dramë, në poezi, në këngë, në kitarë e piano, si dhe përmes krijimeve të nxënësve, u përcollën mesazhe të shumta edukuese.

Vëmendje e veçantë iu kushtua shkrimtarëve shqiptarë të ndaluar në periudhën e regjimit komunist, përmes rubrikës "Letërsia e burgut" realizuar nga nxënësja Erlisa Demneri. Ne jetojmë të tashmen, por e shkuara është ajo që e ka ndërtuar të tashmen tonë, ndaj kujtesa historike mban gjallë shpirtin e çdo populli dhe siguron përparimin e tij.

Nxënëset Jusra Hoxha dhe Xhemile Husha interpretuan prozën e shkurtër "Sokrat i vëjtun apo derr i kënaqun", nga Migjeni. Në skenë u përball zvetënimin shpirtëror me mirëqenien e zbrazët materiale. Kjo është sfida e çdo kohe. T'i qëndrosh besnik parimeve të tua, të jesh i përkorë me veten apo të bëhesh pjesë e turmës pa kurrfarë gjykimi?




Bora Sulstarova duke interpretuar poezinë me titull "Jo luftës",
(Ukrainës), të cilën e ka shkruar e frymëzuar nga aktualiteti politik.

*Dikur, luledielli do të çelë sërish,
koha do të sjellë paqe e mirësi,
dhe njerëzit do të jenë bashkë,
e do të falin shpresë e dashuri.*

NËPËRMJET ARTIT PËRJETËSOHET BUKURIA E JETËS !

Gjimnazi *TES* vizitë në ekspozitën "Çamëria" të piktorit të mirënjohur shqiptar, Rakip Shabani



RAKIP SHABANI
PIKTOR



Piktori i njohu nxënësit me vlerën e artit, rëndësinë e njohjes së artit të vërtetë, e zgjoi përmes pyetjeve shumë kureshtje në mendjet e secilit.

**E dini ç'është arti?
(Pyetja që vuri qetësinë në sallë.)**

Arti është ndjenjë. Ka njerëz që kanë sy e nuk shohin, kanë veshë e nuk dëgjojnë, kanë gojë e nuk dinë të flasin. Arti duhet kuptuar, duhet njohur.

Piktori na tregonte me gisht simbolet në piktura dhe interpretonte subjektet e secilit krijim. Tek fliste ndienim pasionin për artin dhe dëshirën për të ndarë me ne shumëçka. Ecte në korridoret e galerisë dhe rrëfente ngjarje të largëta për ne, por të cilat ai i pikturonte para syve tanë.



Pas pak e pyetëm:

Çfarë ndieni kur shkëputeni nga punimet tuaja? A lidheni shpirtërisht me to gjatë punës?

Ato janë si fëmijët e mi. Kujdesem që të shkojnë në familje që e duan artin e ku do të respektohen.

Figurat femërore të shkrira me mjedise të përçudnuara nga betejat, me qytete të braktisura, ose të hënëzuara mes demash na tërhoqën vëmendjen.

Piktor, a mund të themi se për ju gruaja është muzë?

Ajo është qenia më e përsosur që Zoti ka krijuar. Prej saj buron jeta, është e magjishme!

Pak më tutje, një pikturë na tërhoqi vëmendjen. Një pikturë në qendër të së cilës pamë të rikrijuar *Mona Lizën* e famshme të Da Vincit mes figurash të lashta egjiptane. Kur e pyetëm piktorin se cila ishte arsyeja që bashkëngjiti portretin e saj me këto simbole egjiptiane, ai u shpreh se *Mona Liza* është një pikturë aq e lashtë, aq ikonike sa simbolet egjiptiane.



VENDIËNDJA, ÇAMËRIA



JASMINA PASHAJ

AROMË MANXURANE NË "TES"



Projekti "Vendlindja" i kthyer tashmë në një traditë në shkollën tonë, sjell në qendër të vëmendjes çdo vit një qytet nga Shqipëria dhe thekson bukurinë e rëndësishme të trashëgimisë së vlerave kulturore. Ne kemi një identitet të përveçëm për të cilin duhet të kujdesemi ta përcjellim të pacënuar brez pas brezi. Një qytet tjetër, me histori lotësh e brengash, një djep ku mëkohet tradita!

KJO ËSHTË ÇAMËRIA, PLAGA QË LËNGON...

Aktiviteti përfshiu forma të ndryshme artistike, piktura, poezi, këngë e valle çame. Emocion të veçantë na dhuroi kënga "Vaj e mall për Çamërinë", me zërin kumbues të solistes Sara Kaçi dhe me zërin fëmijënor të Akid Mehmetit. Nxënësi Bekim Allaraj drithëroi publikun me interpretimin e disa vargjeve rrëqethëse. Duartrokiteje e ovacione pati dhe për vallen e Osman Takës, e cila u interpretua nga klasat e dyta dhe të treta.

Të pranishëm ishin prindër, nxënës dhe disa të ftuar nga Shoqata e Çamëve. Mes tyre z. Alket Veliu, Kryetar i "Fondacioni Çamëria 'Hasan Tahsin' ", shkrimtari dhe kryeredaktori i gazetës "Çamëria", z. Arben Iljazi dhe shkrimtari Arben Kondi. I ftuari i nderit, z. Hysni Alushi, këngëtar i mirënjohur i muzikës çame, i emocionoi të gjithë me zërin e tij të veçantë.

NE RRSIM BREZA DUKE TRASHËGUAR VLERA!



FESTA E MËSUESIT NË "TES"

JU U JEPNI NXËNËSVE KRAHËT E DIJES DHE U SIGURONI
ATYRE FLUTURIMIN E SIGURT NË STUHITË E JETËS!



SECILI PREJ JUSH ËSHTË NJË PLOTËS I SË TËRËS E TË
GJITHË SË BASHKU NDËRTOJMË NË KËTË SHTËPI
TONËN, TË ARDHMEN E SHOQËRISË!





BËHUNI MËSUESIT QË DO TË DONIT TË KISHIT PASUR!

NGA IRIDA XHURA

Tiranë, më 07 mars 2023



Miq,

Është dita jonë sot.

Ju kujtohet vetja në bankat e shkollës? Cili imazh ju shfaqet? Me siguri secili prej nesh e ka një mësues që i gdhendi një vlerë, e një tjetër që e shtyu të bëhet më i fortë. (A urove ndonjë nga ish-mësuesit e tu?) Nuk është vetëm një festë, është një ditë reflektimi, vlerësimi, shkëmbimi, mirënjohjeje. Ne jemi shpesh në dyzime për zgjedhjen e punës sonë, sepse ndryshe nga të tjerat, kjo jona nuk është vetëm një punë.

Është një mision!

Kur bëhesh mësues, bëhesh mësues brenda dhe jashtë punës, bëhesh model publik dhe ndonjëherë ndihesh si "VIP" i vëzhguar.

Duhet të jesh i përkorë!

Ajo që ne bëjmë ka një ndikim të pashlyeshëm në kohë: çdo fjalë e çdo veprim yni është një model, çdo buzëqeshje është një mbështetje, çdo sugjerim a vërejtje është një mësim. (Unë nuk i kujtoj sot ekuacionet apo derivatet, por kujtoj me shumë mirënjohje e përlësi zërin e butë dhe durimin e pashembullt të profesorit tim të matematikës.)

Ne përcjellim urtësinë e jetës përmes fjalëve dhe veprave tona!

Vetëm ne, mes njëri-tjetrit, arrijmë ta kuptojmë peshën që mbajmë mbi ndërgjegje, ndaj unë dua t'ju them: **Ndihuni krenarë për veten!** Nuk është vetëm një festë, është një ndalesë për të kuptuar sa të rëndësishëm jemi me atë që bëjmë çdo ditë, sa të pazëvendësueshëm jemi për atë që rritet çdo ditë, sa të mrekullueshëm jemi për durimin e dëshirën e pashtershme për dije e zhvillim. Nëse zëri brenda vetes të thotë të vazhdosh, atëherë misioni që ke zgjedhur të përket. Unë ju uroj durim e kthjelltësi!

Bëhuni mësuesit që do të donit të kishit pasur!

Me dashuri,
Irida



TOMORROW'S EDUCATION SYSTEM

“SIKUR TË GJITHË TË ULËRININ DHE TË DËGJONIN
ULËRIMËN E TJETRIT !”

NAUM SHUNDI



"TË BASHKOHEMI TË GJITHË, DORË PËR DORE, SHPATULL PAS SHPATULLE, E BASHKË TË BËRTASIM ME SA TË NA MBAJË FYTI, ASHTU SIÇ NA KA QËLLUAR TË BËRTASIM NË SKENAT E TEATRIT, PËR TË ZGJUAR NDËRGJEGJEN E BOTËS, PËR TË KËRKUAR BRENDA NESH THELBIN E HUMBUR TË NJERËZIMIT."

RAJMONDA SHUNDI



ERVIN BEJLERI

TOMORROW'S EDUCATION SYSTEM

ART, FILOZOFI, KULTURË PËRMBLEDHUR NË TEATËR.



41

TRA 400

"KENI DEGJUAR QË THONË SE KA ARDHUR NJË KOHË QE PO HA NJERIU NJERIUN? NUK I HA MISHIN DHE KOCKAT, JO! I HA ZEMRËN DHE SHPIRTIN. DHE I GJORI VDES. DHE PO KËTA, QË E HËNGRËN, I SHKOJNË NË VARRIM DHE THONË: "SA I MIRË KA QËNË!" MË MIRË TË THONIN: "SA SHIJE TË MIRË KISHTE!" .
KANIBALË MODERNË!


41

TRA 400



THIRRJA PËR VËMENDJE NDAJ TJETRIT, THIRRJA PËR HUMANIZËN DHE DASHURI KUMBOI FORT NË SALLËN E TEATRIT "**ZONJA E BUJTINËS**", PËRMES DY MONODRAMAVE NGA REGJISORI I MIRËNJOHUR, **NAUM SHUNDI**.

AKTORËT **RAJMONDA SHUNDI DHE ERVIN BEJLERI** PËRFSHINË NXËNËSIT NË SALLË PËRMES INTERPRETIMEVE TË NDJERA.



GJUHA SHQIPE ËSHTË GJUHA E SHPIRTIT, GJUHA E GJYSHËRVE TANË, E RRËNJËVE TONA!

ANXHELA ÇIKOPANO

Me rastin e Ditës Ndërkombëtare të Gjuhës Amtare e ftuar në shkollën tonë ishte studiuesja, regjisorja, përkthyesja e mirënjohur Anxhela Çikopano. Në një bisedë të ngrohtë të udhëhequr nga mësueset Orilda Kalami dhe Irida Xhura ajo rrëfeu për sfidat në përkthim dhe për sukseset.

Sa pasuri ofron gjuha shqipe në përkthimin e veprave të huaja? Ne shpesh dëgjojmë nga nxënësit, por edhe nga mësuesit e gjuhës angleze, se nuk e përkthejnë dot një frazë pasi do t'i humbiste bukurtingëllimi, apo se në shqip mungon fjala gjegjëse. Si e shihni ju këtë raport?

Znj.Çikopano: *Gjuha shqipe është mjaft e pasur, por duhet ta zotërosh atë. Unë u sugjeroj nxënësve që sa herë të lexojnë të mbajnë shënim fjalët e reja që hasin. T'ua zbërthejnë kuptimet e t'i përdorin në kontekstet e duhura. Kjo është një mënyrë e mirë për ta zgjeruar leksikun tonë. Nuk ka fjalë që nuk përkthehen dot, por jemi ne që nuk njohim gjuhën tonë.*

Disa kryevepra të letërsisë botërore janë ripërkthyer në mënyrë shumë dinjitoze. Mendoni se ka ndodhur kjo për shkak të nevojës që lind me ndryshimet që pëson gjuha shqipe, me kontekstualizimin e disa frazave që me kohën e humbasin bukurinë e tyre, duke u përdorur në kontekste të tjera jashtë veprës?

Znj.Çikopano: *Ripërkthimi është i nevojshëm pasi gjuha është në ndryshim të përhershëm e disa fjalë apo toje fjalësh e humbasin freskinë e bukurinë në tingëllim, ndaj ndihet nevoja që të ripërkthehen.*

Ndihet nevoja këtu e një kritike të mirëfilltë letrare që do të kalonte në filtër disa autorë/vepra/përkthyes dhe do të ndihmonte në orientimin e lexuesit?



ANXHELA ÇIKOPANO





Znj.Çikopano: *Është e drejtë. Lexuesit i mbetet të zgjedhë mes shumë përkthimesh. Unë do të thoja se ka disa përkthyes cilësorë të cilët unë i çmoj. Të zgjedhin mes emrave më të njohur, si Amik Kasoruh, Robert Zhvarc, përkthimet e Shekspirit nga Noli për shembull. Të kenë kujdes të zgjedhin përkthyes të afirmuar. Mos harroni se përkthimi është punë, e si në çdo profesion disa e bejnë mirë punën e tyre e disa jo.*

Nxënësja Erlisa Demneri, ka përgatitur një material krahasues mbi përkthimin në gjuhën shqipe të romanit “Aventurat e Tom Sojerit” dhe ka vërejtur disa ndryshime mes përkthimeve. Kjo është një vepër e përkthyer mjeshtërisht edhe prej jush, ndaj jemi kureshtarë për qasjen tuaj.

Znj.Çikopano: *Vërtet? Uau! Jam shumë kurioze të shoh si e ka perceptuar përkthimin tim.*



Pas prezantimit të Erlisës, e cila vuri në spikamë gjallërinë e ritmin e gjuhës së përkthyeses, kjo e fundit u emocionua dhe shprehu vlerësimet më të larta.

Znj.Çikopano: *Jam e befasuar. Nuk e prisja. Të lumtë për qasjen dhe faleminderit për vlerësimet. Është e vërtetë se gjuha ime në përkthim vjen më e shpejtë, kjo në mënyrë të qëllimshme, sepse vetë ritmi i jetës ka ndryshuar. Gjërat janë përsheptuar tani. Të gjithë vrapojmë çdo ditë. Nuk ka kohë për të humbur. Analiza të tilla nuk i kam parë as në detyrat e studentëve në fakultet. Të përgëzoj!*

Mes gjuhëve të huaja që ju i zotëroni mjeshtërisht, ç’vend zë gjuha shqipe?

GJUHA SHQIPE ËSHTË GJUHA E SHPIRTIT, GJUHA E GJYSHËRVE, GJUHA E RRËNJËVE TONA QË MË JAPIN IDENTITET. SADO MIRË T’I ZOTËROSH GJUHËT E HUAJA, ATO MBETEN TË HUAJA. KUR TË QAN A KUR TË KËNDON SHPIRTI, VETËM SHQIP TË VJEN TË BËRTASËSH. DUAJENI GJUHËN E BUKUR SHQIPE, ÇMOJENI DHE ZOTËROJENI!

KLUBI I LIBRIT NË MUZEN “SHTËPIA STUDIO KADARE”

Të ecje në hapësirën ku është ngjizur krijtaria kadareane ishte një emocion i perveçëm. Arkitektura e shtëpisë, oxhaku, studioja, të gjitha një histori më vete.



Ne kishim hyrë fizikisht në mbretërinë e fjalëve të medalionit të letërsisë shqipe, Ismail Kadare.

KLUBI I LIBRIT, MËSUESJA IRIDA XHURA DHE SPECIALISTJA E MUZEUT ERILDA SELAJ



AISEL KËRÇISHTA DHE KRYEMINISTRI I SHQPËRISË, Z. EDI RAMA

NXËNËSJA QË TËRHOQI VËMENDJEN E KRYEMINISTRIT

PUNIMI ME RAPIDOGRAF I NXËNËSES AISEL KËRÇISHTA U BË PJESË E KONKURISIT TË PËRVITSHËM KOMBËTAR ME TEMË “SHQPËRIA IME”. MES QINDRA PUNIMEVE, AISELI RRËMBEU VËMENDJEN E KRYEMINISTRIT, Z. EDI RAMA DHE MINISTRES SË ARSIMIT, RINISË DHE SPORTIT, ZNJ. EVIS KUSHI, TË CILËT U BEFASUAN NGA TALENTI I SAJ.



AISEL KËRÇISHTA DHE ZNJ. EVIS KUSHI, MINISTRE E ARSIMIT DHE E SPORTIT




Aiseli mori pjesë me një punim grafik të kalasë së Beratit të realizuar me anë të teknikës së rapidografit.





EKSPOZITA E PIKTURËS



Klubi i artit finalizon vitin 2022-2023 me ekspozitën e 3-të. Spikasin nxënësit me punime të teknikave të ndryshme si tempera, karbon, laps, pastela, tezgjah etj.. Këto punime dëshmojnë një nivel të lartë artistik dhe dashuri për artin si rrjedhojë e punës së përkushtuar të piktoreve Sonila Mehmeti & Aldeina Seferi. Me dëshirën dhe punën për një të ardhme më të mirë nën sloganin e shkollës "TES" mund të themi me bindje se kjo e ardhme ka për të qënë dhe e bukur plot shije dhe ngjyra.





ERLISA DEMNERI, NGA SHKOLLA "TES" DREJT E NË "HARVARD"

ERLISA DEMNERI, NXËNËSE NË KLASËN XII, SHQUHET PËR REZULTATE TË SHKËLQYERA NË MËSIMET DHE PËR PJESËMARRJE DINJITOZE NË AKTIVITETE, KONKURSE E OLIMPIADA TË FUSHAVE TË NDRYSHME.

Erlisa, ju jeni maturante. Edhe pak ditë ju ndajnë nga përfundimi i këtij cikli studimesh. Në këtë çast reflektimi, a mund të na tregoni si ka qenë rrugëtimi juaj në shkollën "TES"?

Mund të them se rrugëtimi im ka qenë i mbushur me të papritura dhe gëzime të shumta. Gjatë tri viteve të gjimnazit, kam pasur mundësinë të provoj eksperiencë të ndryshme dhe të përfshihem në fusha të shumëllojshme, si matematika, biologjia, kimia, ekonomia, filozofia dhe letërsia. Përshtypja, e cila lë një shije të ëmbël në mendimet e mia, është mundësia që m'u dhurua për të marrë pjesë, për të organizuar dhe drejtuar aktivitete përmes bashkëpunimeve të ndryshme. Pjesëmarrja ime në këto aktivitete u bë e mundur nga mësueset përkatëse, të cilat më bënë pjesë të procesit mësimor e të jetës shkollë dhe patën besim tek unë.

Nga ana tjetër, kjo periudhë ka qenë gjithashtu e mbushur me vështirësi dhe pasiguri. E përballur në fillim të klasës së dhjetë me mundësi nga më të ndryshmet, ishte një sfidë për mua organizimi i pritshmërive dhe përparësive. Rruga që kam ndjekur ka qenë e gdhendur me kujdes, e udhëzuar dhe e mbështetur vazhdimisht nga prindërit e mi, sidomos nga mamaja ime.

A ju kanë ndihmuar cilësitë dhe metodat e shkollës për të qartësuar synimet dhe objektivat tuaja për të ardhmen?

Mendoj se një ndër cilësitë më ndihmuese të shkollës ka qenë komuniteti i formuar mes mësueseve dhe nxënësve. Së pari, kam pasur mundësinë të bashkëpunoj me shumë mësuese nga lëndë të ndryshme, të cilat më kanë ofruar burime dhe organizime të shumëllojshme. Dëshira ime e bashkuar me atmosferën mikpritëse më ka ndihmuar të konkurroj në olimpiada si: British Biology Olympiad, Intermediate Biology Olympiad dhe Biology Challenge, por edhe të provoj eksperiencë të reja, si intervista dhe leksione.

Një ndër aktivitetet që unë kam vlerësuar më shumë gjatë këtij rrugëtimi kanë qenë takimet e ndryshme me figura të shquara nga arti, letërsia, politika, të cilët përzgjidheshin me kujdes dhe sipas temave të zgjedhura nga mësueset organizuese. Këto takime jo vetëm që kanë qenë një eksperiencë e vecantë për të marrë njohuri të reja, por edhe kanë zhvilluar aftësitë e mia të mendimit kritik. Gjithashtu, në shkollë kam pasur mundësinë të formoj miqësi të vryera, të cilat mendoj se do t'i çmoj për vite të ardhshme.

A kujtoni një aktivitet, shkollor ose jashtëshkollor, i cili ju ka ndikuar dhe ka lënë mbresa të thella te ju?

Do të ishte e vështirë të veçoja vetëm një, por do të përzgjedh një aktivitet i cili besoj se përfaqëson shumë prej elementeve të rrugëtimit tim. Unë isha një ndër gjashtë përfaqësuesit e ekipit kombëtar në Olimpiadën Ndërkombëtare të Matematikës (International Mathematical Olympiad - IMO) 2022, e zhvilluar në Oslo, Norvegji. Kjo olimpiadë ishte e veçantë për mua në më shumë se një mënyrë. Së pari, ishte rezultat i shumë muajve përgatitje, të mbushur me teste përzgjedhëse. Së dyti, ishte një pikë kulmore e rrugëtimit tim matematikor, i cili ka nisur tetë vjet më parë, në klasën IV. Ishte gjithashtu një kohë reflektimi, një javë e shpejtë për t'u mahnitur me qytetin e Oslos.

Gjatë aktiviteteve, pata kënaqësinë të flisja për pak çaste me zonjën Marianne Borgen, kryetaren aktuale të bashkisë së kryeqytetit. Ne folëm për mungesën e vajzave në garat shkencore STEM dhe se si kishim rënë në dashuri me fushat tona përkatëse. I tregova znj. Borgen katalizatorin e udhëtimit tim, shumë e Gausit, formula e cila më mahniti kur mamaja ma shpjegoi në fillim të rrugëtimit tim.

Ky aktivitet për mua përfaqëson fuqinë e vërtetë të dijes. Dija më ka lejuar të udhëtoj më tej sesa mund ta imagjinoja, si mendërisht ashtu edhe fizikisht. Më ka lejuar të takoj njerëz të mrekullueshëm dhe të krijoj kujtime që do t'i ruaj gjithmonë. Arsimi ka qenë një rrugë dhe një çelës, dhe shpresoj të mbetet i tillë edhe në të ardhmen.

Ndërsa flasim për të ardhmen, mund të na përshkruani emocionet që përjetuat tek hapët letrën e pranimit në Universitetin e Harvardit, dhe si jeni ndierë këto ditë?

Ishte vërtet një nga momentet më emocionuese dhe më të bukura që kam përjetuar derimë tani. Pranimi ishte tepër i papritur, për shak se universiteti njihet për përqindjen tepër të ulët të pranimeve, vetëm 3.41% të pranuar këtë vit nga 56,937 aplikime. Në të njëjtën kohë, ishte përmbushje e një ëndrre disavjeçare, dhe një vlerësim i mikpritur. Natën që mora rezultatit (për shkak se rezultatet dilnin në orën 1 të natës), pothuaj nuk fjeta fare.

Nuk mund të them me siguri përse jam pranuar ose cila pjesë e aplikimit tim u ka bërë më shumë përshtypje, por i jam thjesht shumë mirënjohëse Zotit dhe njerëzve që më kanë ndihmuar për këtë mundësi, dhe shpresoj ta përdor sa më mirë në të ardhmen.

Ju jeni pa dyshim një model frymëzimi për shumë nxënës. Për ta përmbyllur, dëshirojmë të përcillni një mesazh frymëzues për të gjithë nxënësit e tjerë që po e lexojnë këtë intervistë?

Sinqerisht, do ta kisha të vështirë të përcaktoja një fjali të vetme, për shkak se çdo nxënës është tepër i ndryshëm, dhe historitë tona personale janë tepër të ndryshme. Shumë prej mirësive që më kanë ardhur kanë qenë të pakontrollueshme prej meje, dhe për të cilat jam shumë falenderuese. Megjithatë, nëse do të duhet të përcaktoja një mesazh, do të këshilloja që çdo emocion, çdo përvojë të përjetohet me masë: as trishtimi të jetë i tepërt, por as gëzimi gjithashtu. Është e pamundur për ne të vlerësojmë plotësisht ndikimin e përpiktë të ndodhive të ndryshme në jetën dhe në ecurinë tonë, por çka mund të kontrollojmë është reagimi ynë, për të cilin duhet të përpiqemi të jetë sa më i duhur dhe i matur.

ERLISA TË FALËNDEROJMË DHE TË UROJMË SHUMË SUKSESE NË ÇDO HAP TË JETËS SATE!



KOSOVA JONË TASHMË 15 VJET E PAVARUR!

Dita e Pavarësisë së Kosovës shënon një çast historik të dashur për të gjithë shqiptarët. Ne jemi mbrujtur me dashuri për këtë vend të begatë dhe këtë dashuri e përcjellim brez pas brezi duke dashur të mbajmë gjallë kujtesën historike, kulturën, etnitetin. Historia na bashkon në rrënjë, ne jemi pjesë e pandarë e së tërës, ndaj festojmë për Kosovën duke uruar që të ketë prosperitet, begati, mbrothësi ndër shekuj.

Në një aktivitet të ideuar dhe organizuar nga mësuesit Klaudja Hazizanj, Endri Llaha, Sonila Mehmeti dhe Aldeina Sefëri, nxënësit mbështollën sallën me emocione përmes interpretimeve të tyre.

Pikturat e krijimet në tre dimensione lanë mbresa të publiku i gjerë që erdhi të shijonte shfaqjen.

U risollën në skenë disa këngë me motive atdhedashurie dhe me vargje të fuqishme patriotike.

Këngët "Baresha", "Adem Jashari" e të tjera, drithëruan zemrat e të gjithëve. Evokimi i një kohe ku dashuria për atdheun ishte lajtmotiv i jetës së çdonjërit, zgjon gjithmonë mall e vlerësim për të shkuarën tonë.

Performanca skenike e nxënëses Enxhi Bardhi i la pa frymë të gjithë. Kjo akrobate e re solli me figura elastike përqaftimin e Shqipërisë me Kosovën.

Në këtë aktivitet morën pjesë të ftuar nga Kosova të cilët janë përfaqësues të fushave të ndryshme, ndër ta z. Bernard Tahir Begolli, Prof. Doktor i asociuar, mjek sportiv, z. Gëzim Qerimi, Doktor i Shkencave të Komunikimit dhe të Gazetarisë, profesor në Fakultetin e Filologjisë, Prishtinë si dhe z. Sead Ujkani, Lektor në Fakultetin Ekonomik të Universitetit në Prishtinë.

URIME E DASHUR KOSOVË!

URIME SHQIPTARË!



ANAIS OSMËNAJ

Ë PARA NË SHQIPËRI NË PUBLIC SPEAKING

ANAIS, JU KENI MARRË PJESË NË KONKURSION NDËRKOMBËTAR PUBLIC SPEAKING DHE KENI PËRFAQËSUAR SHQIPËRINË ATJE. A MUND TË NA PËRSHKRUANI RRUGËTIMIN, NDJESITË DHE TË NA TREGONI MË TEPËR RRETH KËSAJ EKSPERIENCË?


“Në fillim që gjithmonë ecën me idenë lërja kohës çfarë do të ndodhë, shijo momentin” ky konkurs nuk ishte asgjë nga çfarë kisha parashikuar. E kam shijuar shumë kohën e përgatitjes për fjalimin megjithëse kam hasur dhe vështirësi, gjithçka u shpërblye me lajmin se kisha kaluar në finale. Për ligjërimin në publik nuk kisha përvojë dhe mendova se nga kjo lloj qasjeje do të mësoja shumë. Kur mora vesh këtë lajm u gëzova tej mase dhe isha e kënaqur me arritjet e mia.

Në finale isha më e emocionuar se kurrë. Teksa dëgjoja konkurrentët e tjerë, mendoja se fitorja ishte e pamundur. Sa hipa në podium, çdo frikë e imja u largua, përfytyroja veten para pasqyrës duke bërë prova dhe ia dola, ia dola ta thoja fjalimin ashtu siç dëshiroja. Pasi sfida më e madhe mbaroi, të parat që pashë ishin fytyrat e gëzuara të mamit dhe të mësueses sime e aty kuptova se ia arrita qëllimit, i bëra krenare!

Koha fluturoi shumë shpejt. Ishte çasti të shpallej emri i fituesit. Isha duke pritur me emocione, kur emri i fituesit u tha, brofa nga gëzimi. Isha unë! Nuk dija çfarë po ndodhte. Më dukej gjithçka një ëndërr, a po ndodhte vërtetë? Emocionet ishin gati mbytëse dhe isha e lumtur që arrita të bëjë krenarë ata që më mbështetën, gjithashtu duke i shpërblyer për përkushtimin e tyre.

A MENDONI SE KJO PËRVOJË KA NDIKUAR TE JU NË ASPEKTE TË NDRYSHME ?


Mora pjesë në këtë konkurs me qëllimin e të pasurit një eksperiencë të re. Kjo eksperiencë ishte tepër mbresëlënëse dhe do të mbetet me mua përgjithmonë. Ajo çka më bëri përshtypje ishte diversiteti i njerëzve, fakti që ishin mendjehapur, por në të njëjtën kohë indiferentë dhe ndjesia e gjykimit nuk ndihej në asnjë aspekt. Me anë të këtij konkursi jo vetëm që arrita të zbuloj një aftësi timen, por edhe të njoh më shumë veten.



CILI ËSHTË MESAZHI PËR BASHKËMOSHATARËT TUAJ TË CILËT DRUAJNË T'I PËRJETOJNË KËTO SFIDA ?

Ky rrugëtim më bëri të kuptoj se mund t'ia dal mbanë vetëm, e pavarur nga askush. Një javë qëndrimi me njerëz plotësisht të panjohur për mua, më bëri të kuptoj se në çfarë mentaliteti të zymtë po jetojnë adoleshentët në vendin tonë. Duke marrë parasysh të gjithë eksperiencën, njohjet e reja, zhvillimin e të menduarit dhe shumë përfitime të tjera që fitova, mendoj se aktivitete të tilla janë një mundësi e artë për të zgjeruar njohuritë dhe për të fituar përvoja.

Kështu, shpresoj dhe i uroj çdo bashkëmoshatari që, nëse i shfaqet mundësia për një eksperiencë të tillë, ta mberthejë dhe mos ta lërë t'i ikë, pasi këto përvoja janë zhvillimi që i duhet çdo individ, rrjedhimisht edhe vendit ku ne jetojmë.



FAMILJA FAKTOR KYÇ NË MIRËQENIEN PSIKOLOGJIKE DHE SOCIALE TË TË RINJVE

Konferenca II e Filozofisë



ORILDA KALAMI

Konferenca e Filozofisë është kthyer tashmë në një traditë të përvitshme të shkollës sonë. Nën kujdesin e mësueses Orilda Kalami, në të enjten e tretë të nëntorit organizohet një takim me pedagogë, studiues në fushën e Shkencave sociale, të cilët paraqesin studimet e tyre. Pjesëmarrësit janë nga të gjitha gjimnazet e kryeqytetit, mes tyre mësues, drejtues e nxënës.

Konferenca II e Filozofisë me temë “Familja faktor kyç në mirëqenien psikologjike dhe sociale të të rinjve” trajtoi një sërë problematikash aktuale përmes optikës së imët të studiuesve Saemira Pino, Lekë Sokoli, Nora Malaj dhe Helena Halilaj.

Sociologia Saemira Pino pati një këndvështrim optimist në lidhje me familjen moderne përballë tradicionales duke thënë se vlera e familjes nuk do të zhduket asnjëherë.





ORILDA KALAMI

FAMILJA, MËSUESIT SHOQËRIA JANË DUART QË ZGJATEN PËR KOMUNIKIM DHE SJELLIN NJË MUNDËSI MË SHUMË PËR DIALOG, AFRIMITET DUKE NDIKUAR NË FORMIMIN E TË RINJVE.

Mësuesja Orilda Kalami paraqiti studimin sociologjik të realizuar me nxënësit e shkollave të mesme dhe listoi si çështje me rëndësi të veçantë komunikimin e shëndetshëm prind-fëmijë, nevojën e të rinjve për të kaluar kohë me prindërit dhe vlerësimin e tyre për rolin e prindërve e për vlerat që ata iu përcjellin.

NORA MALAJ



LEKË SOKOLI

Lidhur me këtë qasje, sociologu Lekë Sokoli u shpreh se familja ka ndikim të rëndësishëm në suksesin e të rinjve. Ai e përfshiu sallën përmes rrëfimit të disa historive të vërteta të suksesit dhe shtoi se forca që njeriu ka brenda vetes është shtysa për t'u zhvilluar në jetë.



SAEMIRA PINO

MË JEPNI NJË FËMIJË TË EDUKUAR MIRË DHE DO T'JU JAP NJË LIDER.

PLATONI

Në ligjëratat e mbajtura u bashkuan për të dhënë qasjen e tyre edhe dy maturante të shkollës sonë, Erlisa Demneri dhe Perlë Muhadri të cilat thkesuan se familja është shtyllë mbështetëse për të krijuar individë të shëndetshëm dhe për të pasur një komunitet aktiv.

ERLISA DEMNERI



PERLË MUHADRI

KLUBI I TEATRIT

ÇFARË ËSHTË GËNJESHTRA? E VËRTETA E MASKUAR!

NGA IRIDA XHURA



MINE MENA
NË ROLIN E OLIMBISË



Në zemër të kryeqytetit, në teatrin “Metropol” Klubi i Teatrit të shkollës shfaqti premierën e komedisë “Karnavalet e Korçës”, me regji nga Suela Bako, ideuar nga mësuesja Orilda Kalami. Komedia e shkruar nga shkrimtari Spiro Çomora u risoll në skenë në dritën e një perspektive bashkëkohore e cila vë në spikamë veset e shoqërisë. Të veshur nën petkun e personazheve, nxënësit interpretuan me pasion e shprehi artistike. Ato ravijëzuan portretet e roleve dhe zotëruan skenën me gjuhë teatrale të lëmuar mjeshtërisht.



KLARK MORINA
NË ROLIN E
LONIT



SARA KAÇI
NË ROLIN E DITRËS





DEA LIMLLARI
NË ROLIN E ASPASISË



ANAIS OSMËNAJ
NË ROLIN E AFROVITIT

Shfaqja solli jo vetëm të qeshura e argëtim, por edhe mesazhe kumbuese. Paraja si forcë lëvizese e botës çon në shembjen e themeleve të vërteta të marrëdhënieve familjare e shoqërore. Rëndësia e arsimit, roli i gruas, lufta kundër fasadës e materiales ishin disa nga temat e prekura përmes komedisë. Me interpretim teatror të spikatur, batutë të rifreskuar e thumbuese, shfaqja e mbajti vëmendjen e publikut të mbërthyer për plot 60 minuta.

Nxënës, mësues, prindër e personalitete të fushave të ndryshme mbushën sallën me duartrokitje e të qeshura.

Teatri është një nga format më të larta artistike e edukuese, ndaj ne synojmë ta ushqejmë ndër breza dashurinë për të duke e kthyer në traditë të përvitshme vënien në skenë të një shfaqjeje teatrale.



IMAD HOXHA DHE MINE MENA
NË ROLET KRYESORE



BEKIM ALLARAJ
NË ROLIN E JANIT



SARA KAÇI DHE ANAIS OSMËNAJ



IMAD HOXHA
NË ROLIN E NIKOLLAQIT

KOMPANIA E NXËNËSVE



MISRI PREJ DRURI ME LIDHËSE



Në kuadër të modulit “Shoqëritë e nxënësve”, i implementuar nga organizata Junior Achievement, maturantët e shkollës sonë menduan krijimin e kompanisë “KacamisTri”. Në fund të vitit shkollor, ata paraqitën një produkt të krijuar dhe të punuar nga vetë ata duke përmbushur kështu qëllimin që ka programi: përgatitjen dhe pëfshirjen e të rinjve në tregun e punës dhe të sipërmarrjes private.

Maturantët e krijuan këtë biznes me qëllim prodhimin e lodrave dhe produkteve ndihmuese, të cilat zhvillojnë aftësitë motorike, njohëse, gjuhësore, sociale dhe shqisore të fëmijëve me aftësi ndryshe, ose të fëmijëve që kërkojnë mbështetje gjatë rritjes së tyre.

Në ditët e sotme, trajtimi i çështjeve sociale nga të rinjtë rrallëherë merr një rëndësi të veçantë. Kështu, kompania e tyre “KacamisTri” u përpoq të krijonte një zgjidhje vërtet me vlerë për komunitetin tonë. Arsyeja përse ata zgjodhën të krijonin këtë produkt është mungesa e lodrave të specializuara përballë nevojës gjithnjë në rritje për vëmendje në këtë problematikë.



STENDA E KACAMISTRIT NË BEAUTY FAIR



KACAMISTRI NË PANAIRIN RAJONAL



JASTËKËT VEPRO DHE PËRQAFO



VAGONI I PËRRALLAVE



TABELA "ZBULO VETVETEN"

SHOQËRIA GATI PËR PUNË



FRENSI ÇIBUKAJ, SIBORA BËRDICA, ORILDA KALAMI, ERLISA DEMNERI,
PERLË MUHADRI, IMAD HOXHA



KACAMISTRIT VLERËSOHET
ME ÇMIMIN "SHOQËRIA GATI PËR PUNË"



Përmes analizës së sëmundjeve të ndryshme dhe organizimit të diskutimeve me profesionistë të fushës, *KacamisTri* krijoi produkte dhe lodra që ndihmojnë në zhvillimin e fëmijëve me aftësi të kufizuara. Dizajni i produkteve u realizua duke përdorur paraqitje të ndryshme grafike dhe softuere kompjuterike. Përzgjedhja e materialeve u krye duke konsideruar nevojat e fëmijëve dhe ndikimin e prodhimit në mjedis.

Duke mbartur me vete edhe personazhin e Kacamisrit (shpesh të shkruar keq edhe si KacamisTri), figura e vogël që paçka kufizimeve arrin të kryejë veprime të mëdha, ata arritën jo vetëm të jenë të suksesshëm financiarisht, por edhe të krijonin një zgjidhje vërtet me vlerë për komunitetin.

"KacamisTri" përfaqësoi denjësisht shkollën "TES" në festivalin kombëtar të kompanive.

Përgjatë dy ditëve me prezantime dhe intervista me jurinë, panairi u finalizua me emocionet e ndarjes së çmimeve.

Juria vlerësoi kompaninë e nxënësve "KacamisTri" me çmimin "Shoqëria gati për punë". Kjo fitore erdhi pas një pune të madhe për të përmbushur kriteret e marketingut, të shitjes, të përgjegjësisë sociale dhe të prezantimit të skuadrës.



DITA E TOKËS

A ndien zërin e natyrës?

Mbylli sytë për një çast dhe dëgjo:

Përshpërimën e drurëve të heshtur, fëshfërimën e gjetheve shtegtare, zhaurimën e ujërave që rrokullisen përposhtë, melodinë e dallëndysheve... Eh, kjo është magjia e shtëpisë sonë të madhe, NATYRËS.

Kjo shtëpi ka nevojë për mua e për ty, sot më shumë se kurdoherë tjetër, ndaj vepro!

Dita e Tokës erdhi kështu në shkollën tonë, me dëshirën për të ndihmuar në një nga kauzat më madhore të këtij shekulli: Mbrojtja e mjedisit!

Përgjatë muajit prill aktivitetet ndërgjegjësuese, edukuese dhe argëtuese sollën pranë nxënësve problemet mjedisore. Kjo ditë na bëri të reflektojmë dhe të hidhemi në veprim të gjithë së bashku.

Dikush mbjell një pemë,
Dikush riciklon,
Dikush bën një thirrje,
Një tjetër reagon!

Mes artit të ngjyrave, të fjalëve, të imazheve, sot kemi plastikë më pak se dje në lumenj, shtëpiza për zogjtë në kopshtin e shkollës, qytetarë më aktiv, më të përgjegjshëm.

Kjo është një sfidë e hapur për të gjithë, gjithmonë: Duaje natyrën, kujdesu për të, riciklo, pastro, mbro!



AKSION PASTRIMI NË TERREN

RICIKLIMI



POSTER NDËRGJEGJËSUES



AKSION PASTRIMI NË TERREN



AKSION PASTRIMI NË TERREN



LEKSION NGA SHOQATA "RIVER CLEAN UP"



SHTËPIZAT E ZOGJVE



NJË PEMË MË SHUMË



L

EARN A NEW LANGUAGE AND GET A NEW SOUL



SHPRESA DELIJA

Me rastin e Ditës Evropiane të Gjuhëve të Huaja u zhvillua një takim informues me përkthyesen, pedagogen, doktoren e shkencave, znj. Shpresa Delija. Ajo solli përvojat jetësore si pedagoge, si frymëzuese e shumë studentëve drejt njohjes së gjuhëve të huaja dhe e vuri theksin te roli dhe rëndësia e zotërimit të tyre në epokën e globalizimit.



E pyetur mbi vështirësitë e të mësuarit të gjuhës së huaj në kohën e regjimit komunist, ajo u përgjigj se ishte sfiduese të gjeje literaturë mbështetëse dhe të krijoje eksperiencë me folës vendas për ta praktikuar gjuhën. Gjithashtu ajo ndau me nxënësit disa histori, copëza jete, arritje e suksese të cilat realizohen kur ke dëshirë dhe pasion, pavarësisht kushteve historike, politike e sociale.

Pedagogia u impresionua nga niveli i zotërimit të gjuhës nga nxënësit tanë dhe i inkurajoi ata ta zhfrytëzojnë maksimalisht infrastrukturën moderne të institucionit ku po arsimohen. Mësuesja ideuese e aktivitetit, Drita Musabelliu, u shpreh se, ky takim shërbeu për ndërgjegjësimin e nxënësve dhe për të vlerësuar larmishmërinë e formave të të nxënimit të gjuhëve të huaja në ditët e sotme.



MARINELA MARKU, SILVA DACI, DRITA MUSABELLIU, SHPRESA DELIJA, ERIOLA RABDISHTI, ANILA BARKIÇI, ELDA MEMISHAJ

JAVA E GJUHËVE TË HUAJA

Words travel worlds, Translators do the driving




Maturantët e shkollës sonë organizuan një shfaqje në gjuhën angleze, të titulluar “No fear literature: Conquering translated fiction, one book at a time”. Organizimi përmbante prezantime me tema të shumëllojshme, duke përfshirë librat, letërsinë, kinematografinë, autorët më të vlerësuar ndërkombëtarë, por edhe performanca muzikore. Ndonëse temat ishin të ndryshme, ato synonin të eksploronin përkthimin dhe ndikimin e tij në jetët tona. Pjesë e organizimit ishte edhe një bashkëbisedim me Dr. Edvin Camin, pedagogun, përkthyesin dhe shkrimtarin e shquar shqiptar. Diskutimi i shtoi edhe më shumë ngjyra aktivitetit, duke krijuar një atmosferë të ngrohtë dhe mikpritëse.



“Shining little scientists” ishte titulli i aktivitetit të klasave të katërta në javën e gjuhëve të huaja.

Nxënësit ndërthurën dijet e marra në lëndën më të re dhe shumë të preferuar prej tyre “Science”, duke ardhur në një aktivitet të mirëfilltë të përbërë nga projekte, eksperimente, këngë, vjersha dhe dramatizime.



Adoleshenca është një fazë sa kalimtare aq edhe përcaktuese në formimin e personalitetit të çdo individi. Nëpërmjet poezive, videove ndërgjegjësuese dhe një filmi të realizuar nga vetë ata, nxënësit realizuan aktivitetin “Being a teen”.

- Adolescence is a new birth, for the higher and more completely human traits are now born.




JAVA E GJUHËVE TË HUAJA





Klasat e pesta erdhën me një aktivitet ku na treguan rëndësinë e sjelljes së mirë dhe na argëtuan me aktrime të ndryshme. Nuk munguan te qeshurat dhe bashkëveprimet me njëri-tjetrin.

Good manners will open doors that the best education cannot.



Culture is the widening of the mind and of the spirit

Klasat e 9-ta sjellën në fokus rëndësinë e vlerave të kulturës. Kultura është mënyra e të menduarit, të sjellurit, muzika, traditat, zakonet, gastronomia dhe aspektet e tjera që përbëjnë popullatën që është pjesë e një shoqërie.




JAVA E SHKENCËS

Aty ku arti shkrihet me shkencat e sakta

Një javë plot me projekte dhe krijime të reja që ngjallën kërshëri të pranishmit. Kjo javë kushtuar shkencës u dha nxënësve mundësinë të vinin në praktikë njohuritë teorike të përvetësuar gjatë vitit shkollor. Njohuritë e përfunduara nga fizika, kimia, biologjia, matematika dhe informatika u konkretizuan në forma të ndryshme shkencore si në periskop, shtyllë kurrizore, trenë shpejtësie, sapunë, faza të mitozës, pasqyrë, mulli ere e shumë eksperimente të tjera.

Kjo javë aktivitetesh u përmbyll me një panair, ku të ftuar qenë edhe prindër e mësues të tjerë, të cilët ndanë kënaqësinë e kësaj eksperience. E kush mund ta mendonte se shkencat mund të ishin kaq argëtuese?



$$E = mc^2$$



KLUBI I PIKTURËS

NË DREJTIMIN E MËSUESVE ALDEINA SEFERI, SONILA MEHMETI

Jo vetëm një aktivitet plot me ngjyra dhe argëtues, por me shumë përfitime.

Fëmijët zhvillojnë aftësi sociale, emocionale, profesionale dhe intelektuale kur pikturojnë. Detyra jonë është t'u sigurojmë atyre lirinë, materialet dhe hapësirën e nevojshme, në mënyrë që kreativiteti i tyre të lulëzojë plotësisht.



BASKETBOLL KLUBI I SPORTEVE VOLEJBOLL

NË DREJTIMIN E MËSUESVE MEGI GJUZI, BRUNO HOXHA

Sporti ka veti mahnitëse dhe të pazakonta, ai mund të njohë dhe bashkojë njerëzit, forcon shëndetin tonë dhe ndikon pozitivisht edhe në aftësitë mendore të një personi, zhvillon aftësi të dobishme të tilla si shpejtësia, reagimi i mirë, forca dhe durimi. Falë sporteve, njerëzit bëhen më elastikë dhe rezistentë ndaj të gjithë faktorëve negativë të mjedisit të jashtëm.



KLUBI I PIANOS & I KITARËS

NË DREJTIMIN E MËSUESIT ADRIAN PLAKALLI

Mësimet e kitares janë një formë fantastike, jo vetëm për të kaluar disa orë ndryshe, por edhe për të ndihmuar në zhvillimin e aftësive thelbësore për fëmijët si: Rritja e përqendrimit, e vetëbesimit, e durimit si dhe e përmirësimit të koordinimit të aftësive psiko-motore.



NË DREJTIMIN E MËSUESESEVE KLAUDJA HAZIZANJ, ONEILA LLANAJ

Aty ku fjalët mungojnë muzika flet! Të mësuarit e një instrumenti e ndihmon fëmijën të shprehet në një formë ndryshe, e zhvillon atë intelektualisht, por edhe emocionalisht! Klubi i pianos në këto dy vite ka rezultuar i sukseshëm dhe është gjithmonë në rritje! Fëmijët e duan artin e muzikës dhe instrumentet muzikore kthehen në një mundësi për të shfaqur talentin e tyre dhe për t'u mësuar me skenën dhe emocionet që ajo të krijon!

KLUBI I TAEKWONDO-SË

NË DREJTIMIN E MËSUESIT JUIRDO CANI

Taekwondo, një art marcial që transmeton një filozofi të thellë të disiplinës dhe të përpjekjes së vazhdueshme për të arritur përsosmërinë. Është si një udhërrëfyes i fortë dhe i besueshëm në rrugën drejt rritjes personale dhe zhvillimit të karakterit. I drejtuar nga profesionisti Juirdo Cani, Klubi i Taekwondo-së po pëlqehet pa masë nga nxënësit e shkollës. Nëpërmjet Taekwondo-së, një sportist bëhet një krijues i vetëm i përsosmërisë, duke u ngritur si shkëndija që ndriçon errësirën e vështrësive, ky është dhe misioni ynë!



"PËR IDE TË MIRA DHE NOVACION TË VËRTETË, KEMI NEVOJË PËR NDËRVEPRIM NJERËZOR, KONFLIKT, ARGUMENT DHE DEBAT." - MARGARET HEFFERNAN

Shkolla "TES" me skuadrën e saj përfaqësuese, të përbërë nga nxënëset Erlisa Demneri, Arlinda Kërzhaliu dhe Rejsi Ahmetaj, kaloi në finalen kombëtare dhe u rendit në 10 skuadrat më të mira në rang kombëtar në konkursin "Debating Economics", të organizuar nga Junior Achievement of Albania. Konkursi synon të ndërtojë një kulturë debati mes të rinjve në Shqipëri, duke inkurajuar mendimin kritik dhe argumentimin.

KLUBI I DEBATIT

NË DREJTIMIN E MËSUESES ORILDA KALAMI

Skuadra pati mundësinë të debatonte mbi tema aktuale si cryptocurrencies, Artificial intelligence dhe Fintech në dy konkurse kombëtare "Debating Economics" dhe "ReDebate".



ARLINDA KËRZHALIU, ORILDA KALAMI, ERLISA DEMNERI, REJSI AHMETAJ



KLUBI I PROGRAMIMIT

NË DREJTIMIN E MËSUESES MIRSIDA MALOKU

Klubi i programimit nisi rrugëtimin e tij në vitin shkollor 2021-2022, në shkollën "TES" nën drejtimin dhe ideimin e mësueses Mirsida Maloku. Ky klub ka ngjallur shumë interes te nxënësit e të gjitha moshave. Aktualisht në klub zhvillohen gjuhë programimi të tilla si: HTML, CSS, Javascript për t'u bërë një Web Developer i vërtetë dhe për të apasionuarit pas krijimit të lojrave Scratch.



KLUBI I ANGLISHTES



Duke përdorur metoda argëtuese, mësimi i gjuhës angleze është bërë edhe më i dashur për fëmijët e klubit. Përvetësimi i gjuhës së dytë përveçse përmirëson funksionimin e trurit, shton përqëndrimin dhe aftësinë për të zgjidhur probleme. Fëmijët mësojnë për kultura të ndryshme dhe udhëtojnë virtualisht në të gjithë botën.



KRYEREDAKTORE: IRIDA XHURA

ARTI GRAFIK: ELARDA ELEZI

KEJSI NIKOLLI

KONTRIBUAN NË REVISTË NXËNËSIT:

ALBORA SHIMA

ARLINDA KËRXHALIU

ERGI ISTREFI

ERIKA MENA

KAMILA KAFELLARI

LEON DEMA

MINE MENA

REJSI AHMETAJ

RUKSANA BREGU

SARA KAÇI

SARA KURTI

SARA HAKIKI



Për një të ardhme më të mirë



Adresa

Rr. Bashkim Shkurti,
Nd 1, Mëzes, Kashar,
1050, Albania



Kontakt

+355 69 37 00 037
sekretaria@gea.edu.al



Orari zyrtar

E Hënë – E Premte
8.00 am – 4.00 pm